



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 133 Vendimi**

**Tiranë, më 03.04.2019**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Roland Ilia</b>	<b>Relator</b>
<b>Olsi Komici</b>	<b>Anëtar</b>

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, sot më datë 03.04.2019, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**Subjektit të rivlerësimit: Z. Halil Vani, Kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.**

**Baza ligjore:** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## I. RRETHANAT E ÇËSHTJES:

1. Me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 26.03.2019, i është njoftuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendimi nr. \*\*\*, datë 28.02.2019, “Për Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës për pension, të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, z. Halil Vani, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të mbushjes së moshës për pension, më datë 26.02.2019, të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, z. Halil Vani.
2. Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim, ligji hyri në fuqi më datë 08.10.2016.
3. Më datë 25.10.16, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë deri në 19 janar 2017. Më datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare, më datë 19.01.2017. Si rezultat afati 30 ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin ka përfunduar në datën 31 janar 2017.
4. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për z. Halil Vani, me funksion Kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ka filluar menjëherë me:
  - a. Plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b. Plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
  - c. Plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41;
5. Më datë 15.03.2018, u hodh shorti pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për trupin gjykues, i cili do të shqyrtojë dhe do të vendosi mbi procesin e rivlerësimit të subjektit Halil Vani.
6. Trupi gjykues i shortuar për këtë qëllim është i përbërë nga:

Olsi Komici	Komisioner
Valbona Sanxhaktari	Komisionere
Roland Ilia	Relator

## II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

7. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”
8. Pika 3 e nenit 179/b i Kushtetutës parashikon se procesit të rivlerësimit i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.
9. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.02.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të mbushjes së moshës për pension, më datë 26.02.2019, të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, z. Halil Vani.
10. Neni 64, pika 5, e ligjit nr. 96/2016, përcakton se: “ *Këshilli deklaroi me vendim mbarimin e statusit të magjistratit jo më vonë se dy javë nga fundi i muajit përkatës*”.
11. Trupi gjykues çmon se objekti për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit apo qëllimi i këtij procesi, është bërë i pamundur, referuar nenit 95, “*Pamundësia në objekt apo qëllim*”, të Kodit Procedurës Administrative, i cili specifikon se: “*Organi publik deklaroi të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”.
12. Ligji nr. 84/2016, në pikën 6 të nenit 4, parashikon se, kur është rasti institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

### PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 4 pika 6 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 64, pika 1, germa “c”, e ligjit nr. 96/2016,

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për **z. Halil Vani**, me funksion Kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.
2. Ky vendim u njoftohet, z. Valil Vani, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë.
3. Ankimi kundër këtij vendimi bëhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, më datë 03.04.2019.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**VALBONA SANXHAKTARI**

**Kryesuese**

**OLSI KOMICI**

**Anëtar**

**ROLAND ILIA**

**Relator**

*Gledis Hajdini*  
*Sekretare gjyqësore*